



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 253 Akti

**Nr. 218 Vendimi
Tiranë, më 10.12 .2019**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------|-----------|
| Suela Zhegu | Kryesuese |
| Lulzim Hamitaj | Anëtar |
| Alma Faskaj | Relatore |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datën 5 dhjetor 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Klodian Kurushi**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.1.2019, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët: Alma Faskaj si relatores, Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj si anëtar.

Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), në përputhje me nenet 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), në përputhje me nenet 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisionere Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar².

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores të çështjes në datën 19.11.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, si dhe njoftimin

¹ Raporti i ILDKPKI -së dërguar me shkresën nr. (***) prot., datë 3.9.2018.

² Raporti i DSIK-së dërguar me shkresën nr(***)prot., datë 29.1.2019 , deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***) prot., datë 24.1.2019, të KDZh-së.

³ Raporti i KLP-së dërguar me shkresën nr. (***) , datë 25.7.2019.

e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit paraprak, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për një proces të rregullt ligjor z. Klodian Kurushi i janë garantuar të drejtat si: është njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin e hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova mbi rezultatet e hetimit paraprak brenda datës 30.11.2019.

Z. Klodian Kurushi ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij brenda afatit të caktuar.

Trupi gjykues i mbledhur në datën 2.12.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi administroi dhe shqyrtoi provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, vendosi të ftojë z. Klodian Kurushi në seancë dëgjimore në datën 5.12.2019, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 5.12.2019, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT / HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. (***) prot., datë 3.9.2018, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Klodian Kurushi.

Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë “Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për periudhën 2003 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; dhe (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

Subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” (duke përfshirë edhe personat e lidhur), në datën 27.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Në “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

Apartament banimi me sip. 79.84 m² regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. pasurie (*), z. k. (***), me adresë: Rr. “(***)”, nr. (***), shk. (***), ap. (***), Tiranë. Apartamenti është blerë përfundimisht pas porosisë me kontratën e shitjes nr. (***), datë 19.11.2013, prej “S.” sh.p.k.**

Burimi krijimi: kredia në shumën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh të marrë nga “Raiffeisen Banka” për shkak të detyrës si gjyqtar me kushte lehtësuese, të cilën vazhdon ta shlyej për llogari të bankës, si dhe pjesa tjetër e çmimit të paguar rrjedh nga kursimet e tij prej pagës dhe shpërblimeve ndër vite.

Vlera 6.300.000 lekë e paguar në tre këste. Kësti i parë në shumën 5.028.000 lekë, i paguar në datën 6.3.2007, me transfertë bankare. Kësti i dytë në shumën 500.000 lekë, i paguar në datën 11.2.2008, me shkresën private. Kësti i tretë në shumën 3.300 euro, paguar në datën 19.11.2013, nëpërmjet transfertës bankare. Pjesa takuese: 100%.

Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ kryesisht dhe provat e administruara

Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007: *“Kontratë porosie “për ndërtim apartamenti me nr. (***), datë 16.4.2007, lidhur me shoqërinë e ndërtimit “S.” sh.p.k., me administrator z. P. K. . Vlera totale është 6.398.000 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë. Sipërfaqja e ndërtimit është 83,8 (tetëdhjetë e tre presje tetë) m²”.*

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, poshtë deklaramit të kontratës së porosisë së apartamentit me shoqërinë “S.” sh.p.k., në vijim subjekti ka deklaruar: *“Pakësim i gjendjes së llogarisë rrjedhëse me nr. (***) (vlera) 5.000.000 lekë; (sqaron) paguar si këst i parë i kontratës së porosisë për apartamentin e banimit të përmendur më lart, ndaj shoqërisë së ndërtimit “S.” sh.p.k.; (vlera) 5.000.000 lekë”*.

Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 16.11.2007, sqarohet se: *“Subjekti Klodian Kurushi bëri plotësimet në deklaramin e tij si vijon: saktësoi të dhënat e deklaratës së Interesave Privatë, viti 2006, faqe nr. 3 për gjendjen e llogarisë bankare në ‘Raiffeisen Bank’ me burim nga kredia e marrë me VKM-në për blerje banese të cilën do ta transferojë në firmën ndërtuese ‘S.’ sh.p.k. gjatë vitit 2007.”*

Më pas, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në të dhënat konfidenciale: *“Pagesë e këstit të fundit dhe fitimi i pronësisë për: 1. Apartamentin Rr. (***) , pll. (***) ap. (***) , Tiranë... (shuma) 1.: 3.300 euro (tremijë e treqind) si këst i fundit i blerjes së apartamentit...”*.

“Raiffeisen Bank”, me shkresat nr. (***)prot., datë 25.7.2019 dhe nr. (***)prot., datë 12.9.2019, si dhe materialet bashkëlidhur, konfirmon kontratën e kredisë, datë **25.9.2006**, me kredimarrës Klodian Kurushi, në shumën 5.000.000 lekë, e cila, deri në datën 25.7.2019, ka mbetur pa u shlyer në shumën 2.165.748 lekë. Sipas kësaj kontrate, qëllimi është përcaktuar për blerje apartamenti. Disbursimi i kredisë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është kryer në datën 25.9.2006; ndërsa në datën 6.3.2007 subjekti ka transferuar shumën **5.028.000 lekë** në llogarinë bankare nr. (***) që i përket shoqërisë “S.” sh.p.k. (P. K.) me përshkrimin **“Klodian Kurushi kontratë sipërmarrjeje për ndërtim një apartament Klodian Kurushi”**.

Për marrjen e kredisë, subjekti ka depozituar në bankë një kontratë sipërmarrje të datës **26.7.2006**, me shoqërinë “F.” sh.p.k., për një apartament tip 2+1, me sipërfaqe 109 m², i përbërë nga 95m² sipërfaqe ndërtim-apartament, plus 12 % të sipërfaqes së përgjithshme të ambienteve të përbashkëta, ndodhur në k. (***) , shk. (***) , e pallatit që do të ndërtohet në Rr. “(***)”, kundrejt çmimit 60.000 euro, për të cilin palët deklarojnë se është likuiduar paraprakisht me nënshkrimin e kontratës.

Kontrata e sipërmarrjes datë 26.7.2006 është autentifikuar me vërtetimin noterial nr. (***) datë 28.7.2006, të noteres E. B., e cila konfirmon se në datën e lëshimit të vërtetimit, në prani të saj, u nënshkrua kontrata e sipërmarrjes (që ka një datë të para dy ditëve: 26.7.2006) nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “(***)” (pra, jo shoqëria “F.” sh.p.k.) dhe z. Klodian Kurushi si porositës.

Këtë kontratë sipërmarrje dhe këtë pagesë në shumën 60.000 euro, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në asnjë deklaratë periodike dhe as në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me marrëdhënien e subjektit me shoqëritë “F.” sh.p.k., dhe “(***)” sh.p.k., si dhe me ortakët e saj: shtetasit A. Ç. dhe F. S., subjekti deklaron se njeh dhe ka marrëdhënie miqësore vetëm me shtetasin A. Ç., me të cilin ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes për një apartament në ndërtesën që po ndërtonte shoqëria “F.” sh.p.k., ku ishte ortak.

Në lidhje me raportin e krijuar, me objekt apartamentin e porositur sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 26.7.2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kontrata është lidhur në kushtet e marrëdhënieve miqësore që kishte me shtetasin A. Ç., duke mos paguar asgjë për sa kanë deklaruar në kontratë. Sipas deklarimit të subjektit, çmimi do të likuidohej pas miratimit të kredisë që do të përfitonte për shkak të funksionit si gjyqtar. Në vijim, për shkak se, pas miratimit të kredisë, shoqëria e ndërtimit ndryshoi destinacionin e përdorimit të objektit (nga objekt banimi në shkollë), po me mirëkuptim, palët nënshkruese kanë zgjidhur në heshtje kontratën e sipërmarrjes, e cila nuk i filloi asnjëherë efektet e saj.

Në lidhje me mosdeklarimin e kontratës së sipërmarrjes apo të kësaj marrëdhënieje interesi, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo situatë nuk është pasqyruar në deklaratën e vitit 2006, për shkak se nuk ka kryer asnjë veprim financiar dhe po kështu, kontrata nuk prodhoi asnjë pasojë juridike brenda atij viti .

Për sa më sipër, subjekti ka shoqëruar përgjigjen e tij me: deklaratën noteriale të shtetasit A. Ç. si ortak i shoqërive tregtare “F.” dhe “(***);” dokumentet financiare të shoqërisë “F.” sh.p.k., për vitin 2006 (pjesë nga libri i blerje dhe shitjeve korrik – dhjetor 2006 të shoqërisë “F.”); raport nga një ekspert kontabël i autorizuar; dhe pasqyrat financiare të vitit 2006 për shoqërinë “F.” sh.p.k (bilanci). Sipas këtyre materialeve shkresore në fjalë konfirmohen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të dhëna në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Raportin e mësipërm e konfirmoi edhe shoqëria “F.” sh.p.k., e cila deklaroi se:

- Shoqëria ka përfituar leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë në datën 18.11.2003, për ndërtimin e një godine të emërtuar “(***),” ndodhur në Rr. “(***),” Tiranë, të cilin e ka regjistruar në bazë të lejes së legalizimit, datë 28.4.2009, nga ALUIZNI, si ndërtesë shumëfunksionale.

- Fillimisht, ndërtesa ishte planifikuar të kishte funksion banim dhe shërbime, me ambiente të destinuar për shitje. Ky funksion u ndryshua më 15.2.2006, kur ortakët kanë themeluar shoqërinë “F. U.” sh.p.k. (me objekt veprimtarie: institucion i arsimit të lartë privat), duke vendosur që të mos i shisnin më ambientet e godinës.

- Ortaku dhe administratori i shoqërisë A. Ç. deklaroi se ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes në datën 26.7.2006, në kushtet e njohjes shoqërore dhe besimit reciprok me subjektin e rivlerësimit, pasi më parë kishin konsumuar biseda rreth nevojës së subjektit të rivlerësimit për strehim dhe mbi trajtimin e tij me kredi nga shteti për shkak të detyrës si gjyqtar. A. Ç. deklaroi se mes tyre është rënë dakord që pjesa kryesore e pagesës do të kryhej në momentin e lëvrimit të kredisë dhe më pas do të përcaktoheshin afatet e pagesës për pjesën e mbetur dhe për shkak të bindjes së kredia do të përfitohej, në kontratën e sipërmarrjes u shënuar si i paguar çmimi i njësisë së banimit. Vërtetimi i nënshkrimit është bërë te noterja ku kryenin veprimet zakonisht, e cila gabimisht ka shënuar në vërtetim emrin e një shoqërie tjetër të shtetasit A. Ç.– “(***)” sh.p.k. Në tetor të vitit 2006, deklaroi se subjekti i rivlerësimit është paraqitur te shoqëria për të kryer pagesën, por pas shpjegimit të situatës (që e quan “situatë të re”), se ndërtesa do të përdorej për qëllime mësimdhënieje, nuk u pranua pagesa dhe marrëveshjen e mbyllën me mirëkuptim.

- Përveç dy ambienteve të shitura te dy subjekte kontraktues, të gjitha ambientet në godinën shumëfunktionale janë në pronësi të shoqërisë “F.” sh.p.k. dhe shfrytëzohen për mësimdhënie nga U. M. i Tiranës (si aktivitet i shoqërisë “F.U.” sh.p.k).

Shoqëria “F.” sh.p.k. ka bashkëlidhur me përgjigjen:

Ekstrakt të QKB-së të shoqërisë “F.” sh.p.k. (NIPT (***)).

Ekstrakt të QKB-së të shoqërisë “F. U.” sh.p.k. (NIPT (***)).

Raportin e ekspertit kontabël për periudhën 1.1.2006 – 31.12.2006.

Librat e shitjes së shoqërisë “F.” sh.p.k., për periudhën korrik – dhjetor 2006.

Deklaratë noteriale nr. (***), datë 30.8.2019, e administratorit të shoqërisë “F.” sh.p.k.

Kontratën e sipërmarrjes, datë 26.7.2006, me subjektin e rivlerësimit.

Kontrata nr. (***), datë 20.10.2016, e shitblerjes së dy pasurive të ndodhura në godinën shumëfunktionale.

Leje ndërtimi nr. (***) prot., datë 18.11.2003, të godinës shumëfunktionale.

Leje legalizimi nr. (***), datë 28.4.2009.

Kontrata qiraje mes “F.” sh.p.k. dhe “F. U.” sh.p.k.

Kartelat e pasurive për ambientet në godinën shumëfunktionale në pronësi të shoqërisë “F.” sh.p.k.

Nisur nga kjo situatë, Komisioni hetoi lidhur me situatën ligjore të shoqërisë së ndërtimit “F.” sh.p.k. dhe “(***)” sh.p.k. (hetime apo procedime penale, apo procese gjyqësore), si dhe kërkoi sqarime të mëtejshme nga subjekti i rivlerësimit, mbi marrëdhënien e tij me këto dy shoqëri tregtare dhe/ose me përfaqësuesin ligjor të tyre. Në të njëjtën kohë objekt i hetimit ka qenë fakti nëse objekti i kontratës ishte ekzekutuar dhe për pasojë, nëse nga subjekti kishte fshehje të pasurisë si në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim të këtij hetimi, nga përgjigjet dhe materialet shoqëruese të ardhura nga gjykatat dhe nga prokuroritë, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të kishte marrë pjesë në asnjë proces ku të ishin palë shoqëritë tregtare dhe/ose përfaqësuesi ligjor i tyre, si dhe nuk rezultuan prova apo *indicie* që të krijonin bindjen se subjekti i rivlerësimit kishte ushtruar ndikim në këto procese, nëpërmjet shfrytëzimit të pozitës së tij si magjistrat, nga ku të kishte realizuar përfitime të padrejta.

Për sa më sipër, në tërësinë e provave të administruara, Komisioni çmoi se rezultoi e provuar se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk kishte bërë likuidimin e shumës së deklaruar në kontratën e sipërmarrjes, pasi nuk rezultoi që shoqëria e ndërtimit “F.” sh.p.k të kishte shitur pasurinë objekt kontrate, e provuar kjo me dokumentacionin e analizuar më lart.
- Rezulton e provuar se dhe sot kjo godinë është dhënë me qira më qëllim ushtrimin e veprimtarisë arsimore dhe për këtë arsye kjo kontratë nuk sollti asnjë pasojë juridike për faktin se objekti i kësaj kontrate ishte bërë i pamundur, pra, nuk ekzistonte më për sa kohë godina kishte ndërruar destinacionin e saj, nga godinë banimi në godinë për ushtrimin e veprimtarisë arsimore. Ky ndryshim kishte passjellë revokimin e shumë kontratave të tjera porosie, të nënshkruara më herët, për apartamente në të njëjtën ndërtesë.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar marrëdhënie të mirëfilltë fiktive me shoqërinë e ndërtimit “F.” sh.p.k. për të fshehur përfitimin e asetit, ndonëse përcaktimi në kontratën e porosisë se çmimi ishte parapaguar përbën një pasqyrim jo real të fakteve.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shfrytëzuar pozitën e tij si magjistrat për përfitime të padrejta, për sa kohë marrëdhënia që kishte nisur – me një person me të cilin kishte një miqësi të hershme – në vijim nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik konkret dhe, për rrjedhojë, asnjë përfitim nga subjekti i rivlerësimit.

Po kështu, për marrjen e kredisë nga “Raiffeisen Bank”, subjekti ka depozituar në bankë një deklaratë noteriale nr. (***) datë 8.9.2006, të nënshkruar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Q. K., përpara noteres A. M., në të cilën deklarohet se i ka dhënë hua djalit të tij Klodian Kurushi shumën 5.000.000 lekë, pa afat kthimi dhe pa interesa (si dhe pa qëllim përdorimi).

Mbi këtë hua në shumën 5.000.000 lekë, të dhënë nga babai i tij, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në asnjë deklaratë periodike dhe as në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me huan në vlerën 5.000.000 lekë, të pasqyruar në deklaratën noteriale të datës 8.9.2006, të babait të subjektit të rivlerësimit, sqaron se kjo deklaratë iu kërkua nga “Raiffeisen Bank”, pasi më parë kjo bankë kishte shqyrtuar dhe analizuar formulimet në kontratën e sipërmarrjes të datës 26.7.2006 që subjekti kishte nënshkruar me shoqërinë “F.” sh.p.k., (më saktësisht, lidhur me formulimin e pagesës së çmimit prej 60.000 euro që kishin përcaktuar palët në kontratë). Gjithashtu, subjekti deklaroi se kjo deklaratë kishte edhe funksionin e një forme garancie ndaj babait të tij, i cili po vendoste barrë hipotekare ndaj banesës së tij për të garantuar kthimin e kredisë së bankës në favor të të birit. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka marrë asnjëherë asnjë shumë hua nga babai i tij, sipas deklaratës noteriale në fjalë, si dhe babai i tij nuk e ka disponuar asnjëherë shumën 5.000.000 lekë deri në datën e deklaratës.

Për sa më sipër, subjekti ka shoqëruar përgjigjen e tij me deklaratë noteriale të z. Q. K. (që konfirmon deklarin e subjektit të rivlerësimit), dhe vërtetimin nga “Raiffeisen Bank” për ndryshim kolaterali.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka informuar Komisionin mbi faktin se bazuar në nenin 10, të ligjit nr. 9110/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krimet e Rënda”, ku parashikohet detyrimi i shtetit për nxjerrjen e akteve nënligjore për masat mbrojtëse të gjyqtarëve, pasi ka cilësuar si situatë të vështirë mospasjen e banesave nga gjyqtarët dhe për këtë i ka drejtuar shkresë KLD-së dhe KM-së për trajtimin me kredi për banesë në rrethana lehtësuese, sipas VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999 (ndryshuar me VKM-në nr. 783, datë 14.2.2005). Bashkëlidhur kësaj kërkese është edhe lista e gjyqtarëve në të cilën figuron edhe emri i subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër Komisioni çmon se deklarata noteriale e babait të subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur me dokumentacionin e “Raiffeisen Bank”, është deklaratë fiktive, dhe ka qenë pjesë e veprimeve të subjektit në përpjekjet e tij për të përfituar kredinë nga kjo bankë për qëllime strehimi (është fakt i provuar se shumica e kredisë së disbursuar e transferuar në llogarinë e një shoqërie ndërtuese për qëllim blerjen e pasurisë apartament banimi), në rrethanat e nevojës

së tij për strehim, por pa ndikuar apo shfrytëzuar për këtë fakt pozitën e tij si magjistrat. Lidhur me këtë rrethanë, ndonëse është i padiskutueshëm fakti i përdorimit të një deklarate fiktive nga subjekti (i cili nuk ka qenë nënshkrues), duhet të mbahet në konsideratë një tjetër specifikë, që konsiston në mosqenien e kësaj deklarate e domosdoshme për arritjen e (qëllimit) të marrjes së kredisë. Kjo pasi – edhe pse banka kredidhënëse është bazuar edhe mbi këtë deklaratë, për aprovimin dhe lëvrimin e kredisë – shumë mirë subjekti i rivlerësimit mund të kishte marrë të njëjtën kredi (për sa kohë posedonte garancitë financiare), duke u mjaftuar vetëm përdorimi i kontratës së porosisë, me kushtin që në këtë të fundit të ishte pasqyruar realiteti, pra, që subjekti i detyrohej shoqërisë ndërtuese shumë e parashikuar si çmim të sendit objekt kontrate, ose edhe vetëm një pjesë të tij (të barabartë me kredinë e marrë). Për rrjedhojë, deklarata fiktive e përdorur vlerësohet më shumë si një veprim sipërfaqësor i pa menduar mirë, i kryer për plotësimin e kërkesës specifike të bankës në fjalë, sesa një qëllim i planifikuar në detaje për të realizuar marrjen e kredisë në mënyrë të paligjshme, pasi kredia mund të ishte marrë edhe vetëm me modifikimin e kontratës së porosisë – duke e çuar përmbajtjen e saj drejt pasqyrimin të realitetit. Për sa kohë deklarata fiktive ka qenë e dobishme por jo e domosdoshme për qëllimin e arritur, kjo rrethanë rezulton më e lehtë se një manipulim i realitetit për përfitimin e diçkaje që nuk mund të arrihej me rrugë alternative.

Për sa më lart, Komisioni çmon se përdorimi i një deklarate fiktive është një element që lidhet me anën etike të magjistratit, e cila në përfundim të gjyqimit, do të vlerësohet në tërësi dhe harmoni me të gjitha provat dhe rrethanat e tjera, që kanë rezultuar nga ky proces rivlerësimi.

Duke iu rikthyer raportit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “S.” sh.p.k., për apartamentin në fjalë, Komisioni analizoi si fillim kontratën e porosisë, datë 16.4.2007, në të cilën palët kanë parashikuar:

- Apartament me sipërfaqe totale: 83.8 m²;
- Çmimi mesatar (për njësi m²) i shitjes: 75.500 lekë/m²;
- Vlera përfundimtare e punimeve: 6.300.000 lekë;
- Likuidime me 3 këste: kësti 1 – në shumën 5.028.000 lekë, menjëherë me lidhjen e kontratës; kësti 2 – në shumën 500.000 lekë, kur përfundon muratura; dhe kësti 3 – në shumën 472.000 lekë, me dorëzimin e çelësave të apartamentit.

Gjithashtu, Komisioni analizoi edhe kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 19.11.2013 (vetëm sa i takon apartamentit), në të cilën palët kanë parashikuar:

- Apartament me sipërfaqe totale: 79.84 m²;
- Çmimi mesatar (për njësi m²) i shitjes: nuk referohet;
- Çmimi: 6.300.000 lekë;
- likuidimi: palët deklarojnë se çmimi është likuiduar dhe apartamenti është dorëzuar.

Transaksioni i mësipërm konfirmohet me shkresën nr. (***)prot., datë 16.9.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, sipas të cilës në emër të subjektit Klodian Kurushi figuron e regjistruar pasuria në z.k. (***) , nr. pasurie (***) , vol. (***) , f. (***) , apartament me sip. 79.84 m², pasuri e fituar me kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 19.11.2013.

Lidhur me saktësinë e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”

Komisioni konstatoi diferencë mes sipërfaqes së apartamentit në kontratën e porosisë së vitit 2007 (83.8 m²) dhe sipërfaqes në kontratën e shitblerjes të vitit 2013 (79.84 m²), si dhe në vlerën përfundimtare të paguar nga subjekti për këtë pasuri. Edhe subjekti i ka deklaruar këto diferenca për të cilat, gjatë hetimit administrativ sqaroi se:

- Në lidhje me marrëdhënien e subjektit me shoqërinë “S.” sh.p.k., dhe me shtetasin P. K. (administrator dhe ortak i shoqërisë), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka krijuar marrëdhënie bazuar vetëm në kontratën e porosisë dhe të shitblerjes së pasurive që ka fituar në pronësi të tij.

- Në lidhje me çmimin e reduktuar në masën 5 %, subjekti i rivlerësimit shprehet se reduktimi konsiston në një pagesë në vlerën 300.000 lekë më të ulët nga çmimi 6.300.000 i përcaktuar në kontratë, çka rezulton nga mënyra e përcaktimit të shumave që duhet të paguajë me këste, në mënyrën si më poshtë vijon:

- Kësti i parë – 5.028.000 (pesë milionë e njëzet e tetë mijë) lekë, menjëherë me lidhjen e kësaj kontrate;
- Kësti i dytë – 500.000 (pesëqind mijë) lekë, kur përfundon muratura;
- Kësti i tretë – 472.000 (katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë) kur porositësit merr të përfunduar apartamentin;
- Total: 6.000.000 lekë.

Për sa më sipër, subjekti i shoqëroi deklaratimet e tij me dokumentacion kontraktor dhe bankar, që lidhen me porositjen dhe transferimin e pronësisë, si dhe të likuidimit të pagesave sipas kësteve të rëna dakord me shoqërinë ndërtuese.

Raportin e mësipërm e konfirmoi edhe shoqëria tregtare “S.” sh.p.k. (sot: “S. E.” sh.p.k.), nëpërmjet shkresave: të datave 29.8.2019; 11.9.2019 dhe 21.9.2019, bashkëlidhur të cilave ka dërguar një kopje të një kontrate shitje, nr. (***), datë 10.11.2013, si dhe certifikatë pronësie që provon se ky apartament ka qenë i riregjistruar në emër të shoqërisë “S.” sh.p.k., nxjerrjen e llogarisë nga “Raiffeisen Bank”, në të cilën pasqyrohen dy pagesat e kryera nga subjekti në datat 6.3.2007 dhe 19.11.2013, si dhe dy mandatarkëtime, njëri i datës 11.2.2008 dhe tjetri i datës 25.5.2010.

Nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe nga shoqëria ndërtuese konstatohet se diferenca e sipërfaqes së porositur me atë që është vendosur në kontratën e shitblerjes së pasurisë, konsiston në sipërfaqen e ambientit të përbashkët në atë godinë (sipërfaqe ideale) që i ka rënë në pjesë apartamentit në fjalë dhe që nuk gjejnë pasqyrim në certifikatën e pronësisë.

Komisioni hetoi mbi situatën ligjore të shoqërisë së ndërtimit “S.” sh.p.k. (hetime apo procedime penale, apo procese gjyqësore), si dhe të ortakut të vetëm dhe njëkohësisht administratorin e saj z. P. K. . Në përfundim të këtij hetimi, nga përgjigjet dhe materialet shoqëruese të ardhura nga gjykatat dhe nga prokuroritë, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të kishte marrë pjesë në asnjë proces ku të ishin palë shoqëria tregtare dhe/ose përfaqësuesi ligjor i saj, si dhe nuk rezultuan prova apo *indicie* që të krijonin bindjen se subjekti i rivlerësimit kishte

ushtruar ndikim në këto procese, nëpërmjet shfrytëzimit të pozitës së tij si magjistrat, nga ku të kishte përfituar zbritjen e çmimit për blerjen e pasurisë.

Në përfundim të këtij hetimit, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë. Nga hetimi nuk rezultojnë dyshime lidhur me vlerën e likuiduar të pasurisë, pasi deklarimi i vlerave të kësteve në kontratën e porosisë përputhet me provat e administruara për shlyerjen e këtyre kësteve.

Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. subjekti ka deklaruar saktë pasurinë si për sa i përket të dhënave të saj dhe deklarimeve për mënyrën dhe vlerën e paguar për likuidimin e saj;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar marrëdhënie fiktive me shoqërinë e ndërtimit “S.” sh.p.k., për të fshehur vlerën e vërtetë të pasurisë;
- iii. subjekti i rivlerësimit nuk ka shfrytëzuar pozitën si magjistrat për përfitime të padrejta.

Lidhur me burimin e ligjshëm

Në analizë të burimit të ligjshëm komisioni kreu analizën financiare lidhur me momentet e shlyerjes së kësteve të apartamentit nga subjekti dhe personat e lidhur me të. Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti ka patur burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit, kështu që është paguar nëpërmjet kredisë bankare në “Raiffeisen Bank”, siç është theksuar dhe më lart para lidhjes së kontratës së porosisë.

Në përcaktimin e aftësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar gjendje kursimesh nga të ardhura me burime të ligjshme, Komisioni mori në analizë të gjitha shpenzimet e subjektit (sipas deklaratimit në deklaratën “Vetting” dhe deklaratimit periodik), si dhe dokumentacionin e siguruara gjatë hetimit.

Komisioni kreu analizën financiare lidhur me shlyerjen e këstit të dytë të apartamentit në shumën 500.000 lekë, shumë e cila sipas deklaratimeve të subjektit është kryer nëpërmjet një shkrese private ndaj shoqërisë në datën 11.2.2008. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore burimin e përdorur prej tij lidhur me këtë pagesë.

Subjekti i rivlerësimit mbajti qëndrimin që prej tij nuk janë deklaruara asnjëherë likuiditete *cash*, të cilat sipas pretendimeve të tij, rezultojnë se kanë qenë, kjo dhe nga analiza financiare e realizuar nga Komisioni.

Komisioni çmoi se ky pretendim nuk është i bazuar për faktin se detyrimet për subjektet deklarues nga ligji për deklarimin e pasurive është i qartë dhe deklarimi i likuiditeteve *cash* përbën një detyrim ligjor të qartë. Ky qëndrim i Komisionit është në përputhje dhe me qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në vendimin nr. (***), në pikën 84 të tij, përcaktohet se: [...] *Lidhur me deklaratimin gjatë gjyqimit mbi mbajtjen e shumës prej 900.000 lekësh si cash në shtëpi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në cash në vlerat 300.000 lekë dhe 600.000 lekë, respektivisht në deklaratat periodike vjetore të vitit 2003 dhe në atë të vitit 2004. Në vijim, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes cash. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë*

ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve cash, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin: “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: [...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].

Në vendimin nr. (***) , në pikën 31 të tij, përcaktohet se: [...] referuar nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, sipas të cilit subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përveç ndryshimeve të ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private, duhet të deklaronte saktë edhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh cash apo në bankë, në fund të çdo viti, prej vitit 2003 e në vazhdim. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet [...].

Për këtë arsye Komisioni realizoi analizën financiare deri në momentin e shlyerjes së kësaj shume, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, deri në datën 11.2.2008. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën **215,296 lekë**. Në vijim tabela e cila reflekton analizën financiare.

| | Nga data 1.1-11.2.2008 |
|--|-------------------------------|
| PASURI deri më 11.2.2008 | 262,845 |
| Apartament banimi shoqëria "****" sh.p.k., paguar kësti i dytë në 2008 | 500,000 |
| Pakësime në likuiditete në bankë | -237,155 |
| TE ARDHURA | 90,839 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 90,839 |
| SHPENZIME | 43,290 |
| Shpenzime për shlyerje kredie deri më 11.2.2008 | 27,730 |
| Shpenzime jetese deri më 11.2.2008 | 15,560 |
| Shpenzime udhëtimi deri më 11.2.2008 | 0 |
| Diferenca (të ardhura - pasuri neto - shpenzime) | -215,296 |

Konfirmohet me dokumentacion se kësti i tretë i kësaj pasurie është shlyer nga subjekti nëpërmjet sistemit bankar së bashku me shlyerjen e këstit të fundit të pasurisë së analizuar më poshtë, garazh, vend parkimi, në të njëjtën ditë, në datën 19.11.2013.

Komisioni realizoi analizën financiare të kohës së shlyerjes, e cila është në vijim të analizës së pasurisë garazh.

Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën prej 3.300 euro për shlyerjen e këstit të tretë të apartamentit.

Për sa më sipër, pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të subjektit, shpjegimeve të tij, në përfundim të hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- i. Subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 215.296 lekë, diferencë e cila do të çmohet në tërësinë e rezultateve të hetimit.

Garazh me sipërfaqe 18 m² regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. pasurinë (***) , z. k. (***) , me adresë Rr. “(***)” pll. (***) , Tiranë. Garazhi është blerë përfundimisht pas porosisë me kontratën e shitjes, nr. (***) , datë 19.11.2013, prej shoqërisë “S.” sh.p.k.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe shpërblimet si gjyqtar (bashkëlidhur kopje të certifikatës së pronësisë, kontratë shitblerjeje, kontratë porosie, datë 25.5.2010).

Vlera **7.000 euro** e paguar me dy këste. Kësti i parë është paguar në datën 25.5.2010 me lidhjen e kontratës së porosisë me shumën 6.000 euro, kësti i dytë është paguar në datën 19.11.2013, në shumën 1.000 euro, me transfertë bankare. Pjesa takuese: 100%.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht dhe provat e administruara

Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010: *“Vendparkimi (garazh) ndodhur në katin e dytë nëntokë, kuota -5,20) me numrin 12, që ndodhet në pallatin me adresë Rr. “(***)”, Tiranë. Vendparkimi është siguruar me kontratën e porosisë datë 25.05.2010 lidhur me shoqërinë “S.” sh.p.k. Pronësia kalon me pagimin e dy kësteve. (vlera) vlera e plotë është 7.000 (shtatë mijë) euro. (pjesa që zotëron) 100%. (sqaron) Kësti i parë i kontratës së porosisë për vendparkimin (garazhin) është paguar më datë 25.05.2010, shoqërisë “S.” sh.p.k. me para në dorë në ditën e lidhjes së kontratës së porosisë. (vlera) Në datën 25.05.2010 është paguar 6.000 (gjashtë mijë) euro (pjesa që zotëron) 100%. (sqaron). Kësti i dytë do t’i paguhet shoqërisë “S.” sh.p.k. kur të regjistrohet vendi parkimit (garazhi) në ZVRPP Tiranë. (vlera) Do të paguhet 1.000 (një mijë) euro kur të realizohet regjistrimi i vendparkimit (garazhit). (pjesa që zotëron) 100%”.*

Më pas, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e të dhënave konfidenciale: *“Pagesë e këstit të fundit dhe fitimi i pronësisë për: 2. Garazh Rr. (***) , pll. (***) nr. (***) Tiranë... (shuma) 2. 1.000 euro (një mijë) si këst i fundit i blerjes së garazhit”.*

Raportin e deklaruar si më sipër e konfirmoi edhe shoqëria tregtare “S.” sh.p.k. (sot: S. E.” sh.p.k.), nëpërmjet shkresave: më 29.8.2019, 11.9.2019 dhe më 21.9.2019, bashkëlidhur të cilave ka dërguar një kopje të një kontrate shitje, nr. (***) , datë 10.11.2013, nxjerrje nga llogaria e shoqërisë në “Raiffeisen Bank” (pagesë për garazh në datën 19.11.2013), si dhe certifikatë pronësie që provon se ky garazh ka qenë i regjistruar në emër të shoqërisë “S.” sh.p.k.

Transaksioni i mësipërm konfirmohet nga ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. (***) prot., datë 16.9.2019, sipas të cilës, në emër të subjektit Klodian Kurushi figuron e regjistruar pasuria në

z.k. (***), nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), garazh me sip. 18 m², pasuri e fituar me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 19.11.2013.

Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë.

Lidhur me burimin e ligjshëm

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për blerjen e një garazhi në të njëjtën periudhë me blerjen e apartamentit (shih pasuria 2), çmimin e të cilit e ka likuiduar në dy këste: **Kësti i parë** është paguar në datën 25.5.2010 me lidhjen e kontratës së porosisë me shumë 6.000 euro, kësti i dytë është paguar në datën 19.11.2013, në shumën 1.000 euro, me transfertë bankare. Për këto shuma, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash: të ardhura nga paga dhe shpërblimet si gjyqtar.

Lidhur me pagesën e këstit të parë prej 6.000 euro, Komisioni kreu analizën financiare referuar kësaj pagese në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë në datën 25.5.2010, duke analizuar burimin e deklaruar nga subjekti lidhur me këtë pagesë për garazhin, si më poshtë:

| | Nga data 1.1 - 25.5.2010 |
|--|---------------------------------|
| PASURI deri më 25.5.2010 | 845,038 |
| Vend parkim, garazh në Rr. “***” ⁴ | 832,860 |
| Shtesa në likuiditete në bankë | 12,178 |
| TE ARDHURA | 421,658 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit ⁵ | 421,658 |
| SHPENZIME | 217,552 |
| Shpenzime për shlyerje kredie deri më 25.5.2010 | 138,649 |
| Shpenzime jetese deri më 25.5.2010 | 55,028 |
| Shpenzime udhëtimi deri më 25.5.2010 | 23,875 |
| Diferenca (Të ardhura - Pasuri neto - Shpenzime) | -640,932 |

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni lidhur me shlyerjen e këstit të parë të garazhit në shumën prej 6,000 euro, e cila rezulton të jetë paguar në datën 25.5.2010, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar të gjithë pagesën prej 6.000 euro për shlyerjen e këstit të parë të garazhit, pasi konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën **640.932 lekë**.

Shlyerja e këstit të dytë të garazhit – sipas informacionit të administruar gjatë hetimit administrativ ka qenë në datë 19.11.2013, prandaj Komisioni kreu analizën financiare deri në momentin e shlyerjes së këstit të tretë të apartamentit, si dhe analizën për të gjithë vitin 2013, si më poshtë:

| | Nga data 1.1 - 31.10.2013 |
|---------------|----------------------------------|
| PASURI | 338,696 |

⁴ Paguar shuma prej 6.000 euro në datën 25.5.2010, kësti i parë i garazhit, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

⁵ Në vitin 2010 subjekti i deklarimit nuk ka qenë i martuar prandaj analiza financiare është realizuar me të ardhurat dhe shpenzimet vetëm të subjektit të rivlerësimit

| | |
|--|------------------|
| Apartament banimi shoqëria "****" sh.p.k., paguar kësti i fundit në 2013 ⁶ | 462,693 |
| Vend parkim, garazh në Rr. "****" ⁷ | 140,210 |
| Pakësime të likuiditeteve <i>cash</i> dhe bankë | -264,207 |
| TE ARDHURA | 1,691,651 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,066,120 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 625,531 |
| SHPENZIME | 1,088,576 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | 277,394 |
| Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga bashkëshortja llogaritur nga viti 2011 e mbrapa | 229,583 |
| Shpenzime jetese | 352,560 |
| Shpenzime udhëtimi | 14,753 |
| Shpenzim arredimi | 214,286 |
| Diferenca (të ardhura - pasuri neto - shpenzime) | 264,379 |

Për sa më sipër, pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të subjektit, shpjegimeve të tij, në përfundim të hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- ii. Subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe mënyrën e likuidimit të saj si në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”.
- iii. Subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e këstit të dytë të garazhit.

Automjet tip “Mercedes Benz, 204, C200CDI”, viti i prodhimit 2009, me targa (***), blerë me kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 24.12.2014.

Burimi i krijimit: paga dhe shpërblime nga puna si gjyqtar, pedagog dhe trajner në Shkollën e Magjistraturës (*bashkangjitur certifikatë pronësie të mjetit rrugor, kontratë shitblerje automjet në gjuhën gjermane, kontratë shitblerje në Shqipëri*).

Vlera 5.000 euro. Pjesa takuese 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, te shpenzimet: “*Shpenzim për blerje automjeti tip Mercedes Benz me targa (***)me leje qarkullimi TR (***) me kontratë shitje automjeti nr. (***) , datë 24.12.2014. Burimi: të ardhura dhe kursime nga paga ndër vite. (vlera) 5.000 (pesëmijë) euro*”.

Nga përgjigja e DPSHTR-së me shkresën nr(***)prot., datë 31.7.2019 dhe materialeve bashkëlidhur rezulton se, me aktin e shitjes së datës 18.12.2014, shtetasi A. G. ka blerë automjetin në fjalë nga subjekti gjerman “N. D.”, kundrejt çmimit 5.000 euro.

⁶ Paguar shuma prej 3.300 euro në vitin 2013, si këst i fundit i vlerës së apartamentit, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013.

⁷ Paguar shuma prej 1.000 euro në vitin 2013, si këst i fundit i vlerës së garazhit, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013.

Bazuar në deklaratën doganore (***), datë 22.12.2014 dhe urdhër çlirim nr. (***), datë 22.12.2014, rezulton se shtetasi A. G. ka likuiduar detyrimet doganore të automjetit në shumën 302.463 lekë.

Bazuar në kontratën e shitjes nr. (***), datë 24.12.2014, shtetasi A. G. i ka shitur subjektin të rivlerësimit automjetin kundrejt çmimit 5.000 euro.

Nga sa më sipër, Komisioni konstatoi se automjeti është shitur më lirë nga vlera e shpenzuar për të pas blerjes së automjetit në Gjermani (shpenzime transporti dhe shpenzime doganore). Gjithashtu, nga subjekti i rivlerësimit nuk është deklaruar likuidimi i detyrimeve doganore dhe as ndonjë raport apo interes i posaçëm mes tij dhe shitësit të automjetit (me profesion avokat), që të ketë ndikuar në shitjen e automjetit në këto rrethana.

Komisioni çmoi që subjekti duhet të japë sqarime rreth dokumentacionit të shitblerjes së automjetit dhe lidhjet e tij me z. A. G., mbi rrethanat e njohjes dhe raportet që ka pasur me të, si dhe mbi shkakun e shitjes së makinës në shumën 5.000 euro, duke mos përfshirë në këtë çmim detyrimet doganore dhe shpenzimet e transportit të paguara më parë nga shitësi i automjetit.

Subjekti në përgjigje të pyetësorit deklaroi:

“Shtetasin A. G. e njoh në rrethana shoqërore përpara vitit 2014. kam pasur dhe vazhdoj të kem raporte shoqërore...”

“...Për këtë qëllim para nisjes për në Gjermani kam derdhur në llogarinë e shtetasit A. G. në Raiffeisen Bank në datën 16. 12. 2014 shumën prej 5 000 (pesë mijë) euro, që përfaqëson vlerën e automjetit”

“...Pasi shtetasi A. G. ka mbërritur në Shqipëri me automjetin tim, dhe akti i blerjes së automjetit ka qenë në emër të tij, ai ka qenë i detyruar të kryejë procedurat e zhdoganimit të automjetit në Drejtorinë e Doganës, Durrës në emër të tij..”

“Shuma e parave e paguar për zhdoganimin e automjetit nuk është deklaruar specifikisht në deklaratën periodike, pasi për kohën e dorëzimit të kësaj deklarate është vlerësuar se referuar formularit të deklarimit, shpenzimet e kryera deri në shumën e 300.000 (treqind mijë) lekëve nuk përbënin një detyrim ligjor për deklarim.

Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gabuar në mosdeklarimin e shpenzimit në shumën prej 302.463 lekë për detyrimin doganor të automjetit të blerë në shumën 5.000 euro, në Deklaratën periodike të pasurive dhe interesave të vitit 2014, por kjo pagesë (shpenzim) nuk ka qenë detyrim për t'u deklaruar edhe në deklaratën “Vetting” në vitin 2017.

Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë.

Lidhur me burimin e ligjshëm

Për sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave nga paga dhe shpërblimet, për krijimin e gjendjes së kursimeve të mjaftueshme për aftësi paguese të çmimit të makinës së blerë në vitin 2014, Komisioni kreu analizën financiare, cila është shtrirë përgjatë gjithë vitit 2014 meqenëse makina është blerë në fund të këtij viti, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

| | 2014 |
|--|------------------|
| PASURI | 484,715 |
| Automjet tip Mercedes Benz me targa ***, 5.000 euro ⁸ | 700,550 |
| Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë | -215,835 |
| TE ARDHURA | 2,405,852 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,454,984 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 903,633 |
| Të ardhura nga interesat bankare | 22,235 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit BMW | 25,000 |
| SHPENZIME | 1,821,401 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | 332,759 |
| Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga bashkëshortja llogaritur nga viti 2011 e mbrapa | 269,866 |
| Shpenzime jetese | 659,994 |
| Shpenzime udhëtimi ⁹ | 42,033 |
| Shpenzime doganore për makinën ¹⁰ | 302,463 |
| Shpenzim arredimi | 214,286 |
| Diferenca (të ardhura - pasuri neto - shpenzime) | 99,736 |

Nga sa më sipër:

Për sa më sipër, pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të subjektit, shpjegimeve të tij, në përfundim të hetimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:

1. Subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe mënyrën e likuidimit të saj si në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”.
2. Subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, deri në datën 31.12.2016

Burimi i krijimit: paga dhe shpërblime nga paga si gjyqtar, pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe si eksperti jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës.

Vlera: 257.547,99 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja me shkresën nr. (***) prot., datë 25.7.2019 dhe nga materialet bashkëlidhur nga “Raiffeisen Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 26.1.2017 të mund të

⁸ Konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.

⁹ Të rezultuara nga sistemi *TIMS* dhe të përlogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit të Apelit lidhur me shpenzimet e udhëtimit

¹⁰ Shpenzimet për pagesën e doganës në shumën 302.463 lekë, shpenzim i cili nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 por në përgjigje të pyetësorit nr. 4 të administruar në Komision në datën 23.9.2019 subjekti ka pranuar se e ka paguar vlerën e doganës por nuk është deklaruar me arsyetimin se ishte shpenzim deri në 300.000 lekë.

krijonte gjendje në shumën 257.547,99 lekë, së bashku me deklarinimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë.

Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se informacioni për ekzistencën e kësaj llogarie daton që nga dhjetori i vitit 2005¹¹ dhe kjo është llogaria rrjedhëse, llogari në të cilën subjekti i kalon paga që nga viti 2005 e në vijim. Në këtë llogari është *disbursuar* dhe kredia në shumën 5.000.000 lekë, në shtator të vitit 2006, që ka shërbyer si burim i pagesës së këstit të parë të blerjes së apartamentit në rrugën “(***)” në Tiranë.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen në “Raiffeisen Bank”, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 257.547,99 lekë në këtë llogari.
- Rezulton se subjekti ka pasur mundësi që të krijonte gjendjen në shumën 257.547,99 lekë deri në datën 31.12.2016.

Kontratë depozitë në “ProCredit Bank” në bashkëpronësi E. Th. K. (bashkëshortja) dhe Klodian Q. Kurushi, hapur në datën 10.12.2014

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe shpërblimet nga puna e bashkëshortes si konsulente kurrikulare dhe pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të (***) në A. U., si dhe nga kursimet nga pagat dhe shpërblimet si gjyqtar, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë Universiteti Tiranë, si dhe ekspert i jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës (bashkëngjitur vërtetimi i bankës, datë 12. I. 2017).

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Komisioni ka nisur verifikimin sipas kërkesës drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë. Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga “ProCredit Bank” rezulton se kjo llogari depozite është çelur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në dhjetor të vitit 2014 dhe është depozituar fillimisht shuma 500 uro.

Më pas janë bërë derdhje sistematikisht nga bashkëshortja e subjektit në shumën 6.250 euro. Përgjatë vitit 2015 në këtë llogari është depozituar shuma prej 4.100 euro nga shtetasja O. K. (S.). Kjo llogari depozite ka qenë aktive deri në dhjetor të vitit 2017 dhe në datën 13.12.2017 është tërhequr nga kjo llogari shuma prej 10,855 euro nga shtetasja E. Th. K. .

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 17.1.2017 të mund të krijonte gjendje në shumën **8.755,64 Euro**, së bashku me deklarinimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

| | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|----------------|----------------|----------------|
| PASURI | 484,715 | 113,226 | 175,374 |
| Automjet tip Mercedes Benz me targa *** | 700,550 | | |
| Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë | -215,835 | 113,226 | 175,374 |

¹¹ Nuk kemi të dhëna nga “Raiffeisen Bank” para vitit 2005 për ekzistencën e kësaj llogarie para vitit 2005

| | | | |
|--|------------------|------------------|------------------|
| TË ARDHURA dokumentuar | 2,405,852 | 3,182,037 | 2,900,370 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,454,984 | 1,515,599 | 1,477,684 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 903,633 | 1,288,117 | 1,174,980 |
| Dhurata të mbledhura nga familjarë dhe të afërm për lindjen e vajzës A. K | | 230,355 | |
| Të ardhura nga interesat bankare | 22,235 | 10,316 | 7,706 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të bashkëshortes Ford Fiesta | | 137,650 | |
| Të ardhura nga dëmshpërblimi si pasojë e akidentit | | | 120,000 |
| Të ardhura nga dhuratat për ditëlindjen e vajzës A. K | | | 120,000 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit BMW | 25,000 | | |
| SHPENZIME | 1,821,401 | 2,415,700 | 1,312,154 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | 332,759 | 313,210 | 344,486 |
| Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga bashkëshortja llogaritur nga viti 2011 e mbrapa | 269,866 | 833,570 | |
| Shpenzime për regjistrimin/vlerësimin e pronës | | | 27,300 |
| Shpenzime për lindjen e vajzës A. K., datë 23.10.2015 në spitalin *** | | 130,000 | |
| Shpenzime jetese | 659,994 | 897,104 | 940,368 |
| Shpenzime udhëtimi | 42,033 | 27,530 | |
| Shpenzim arredimi | 214,286 | 214,286 | |
| Shpenzime doganore për makinën | 302,463 | | |
| Analiza dokumentuar | 99,736 | 653,111 | 1,412,842 |

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në bankën “ProCredit Bank”, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës.
- Rezulton se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar depozitën dhe për të justifikuar shtesat në këtë depozitë për periudhën 2014 – 2017, në shumën 8.755,64 euro deri në datën 17.1.2017.

Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të J. K. (bija e mitur e deklaruesit), krijuar më 11.8.2011 nga gjyshi Q. K. .

Burimi i krijimit: të ardhura në formën e dhuratave të mbledhura nga familjarët, të afërm dhe miq për festa, datëlindje dhe gëzime të tjera, të ruajtura dhe depozituara me rastin e ditëlindjes dhe festave të fund vitit (bashkëngjitur vërtetimi “statment” i bankës).

Vlera 678.104,48 lekë. Pjesa takuese 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja e “Raiffeisen Bank”.

Llogaria e kursimit e vajzës së subjektit të rivlerësimit është çelur në muajin gusht të vitit 2011 nga një derdhje në shumën prej 100.000 lekësh nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Në datën 13.8.2012, një vit më vonë është depozituar në këtë llogari shuma prej 230.000 lekësh nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Q. K. . Nga viti 2013 dhe deri në janar të vitit 2017 nga

bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, është depozituar në këtë llogari shuma prej 225.000 lekë. Në dhjetor të vitit 2015 nga subjekti i rivlerësimit është depozituar në këtë llogari shuma prej 27.415 lekësh dhe në dhjetor të vitit 2016 është depozituar shuma prej 23.500 lekësh dhe në total subjekti i rivlerësimit ka depozituar në këtë llogari shumën prej 50.915 lekë.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 12.1.2017 të mund të krijonte gjendje në shumën **678.104,48 lekë**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë.

Në vijim, është analizuar aftësia e personave të tjerë të lidhur, prindërve të bashkëshortit, për të dhuruar shumat e deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në “Raiffeisen Bank” në emër të vajzës së subjektit, J. K., si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës.
- Rezulton se subjekti, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme që të krijonin gjendjen në shumën 678.104,48 lekë deri në datën 12.1.2017.

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të A. K., E. K. (vajza e mitur e deklaruesit) hapur në datën 12.1.2017, nga deklaruesi dhe bashkëshortja

Burimi i krijimit: dhurata të mbledhura nga familjare dhe të afërm që nga lindja e vajzës A. K., në tetor 2015, në ditëlindjen parë të saj në tetor 2016, si dhe festat e fund vitit (bashkangjitur vërtetimi "statment" i bankës).

Vlera 2.500 euro. Peja takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting: konfirmohet nga përgjigja e “Raiffeisen Bank”.

Kjo llogari është çelur në janar të vitit 2017 nga një depozitim i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në shumën prej 2.500 euro dhe më pas në këtë llogari bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka derdhur një shumë prej 420 euro në qershor të vitit 2018. Kjo llogari rezulton të jetë aktive deri në këtë moment.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 12.1.2017 të mund të krijonte gjendje në shumën **2.500 euro**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

| | 2016 |
|---|------------------|
| PASURI | 175,374 |
| Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë | 175,374 |
| TË ARDHURA dokumentuar | 2,900,370 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,477,684 |

| | |
|---|------------------|
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 1,174,980 |
| Dhurata të mbledhura nga familjarë dhe të afërm për lindjen e vajzës A. K | |
| Të ardhura nga interesat bankare | 7,706 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të bashkëshortes tip “Ford Fiesta” | |
| Të ardhura nga dëmshpërblimi si pasojë e aksidentit | 120,000 |
| Të ardhura nga dhuratat për ditëlindjen e vajzës A. K | 120,000 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit BMW | |
| SHPENZIME | 1,312,154 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | 344,486 |
| Shpenzime për regjistrimin/vlerësimin e pronës | 27,300 |
| Shpenzime jetese | 940,368 |
| Analiza dokumentuar | 1,412,842 |

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen në “Raiffeisen Bank” në emër të vajzës së tij, A. K., si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 2.500 euro në këtë llogari.
- Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme që të krijonin llogarinë e kursimit në emër të vajzës në shumën 2.500 euro deri në datën 12.1.2017.

Gjendje *cash* në lekë të pa depozituara në bankë. Burimi i krijimit kursime nga pagat dhe shpërblimet të deklaruesit dhe bashkëshortes

Vlera: 470.000 lekë.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të subjektit dhe personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara në deklaratën “Vetting”, të mund të krijonte gjendjen *cash* në shumën 470.000 lekë, së bashku me deklarinimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë deklaratë të interesave privatë periodikë vjetor kursime *cash*. Për herë të parë subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar kursime *cash* në deklaratën “Vetting”, në shumën 470.000 lekë. Nga analiza financiare e vitit 2016 (e trajtuar në tabelën e mësipërme), duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e kursimeve *cash*, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e gjendjes së lekëve në këtë shumë.
- Rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme që të krijonte gjendjen e kursimeve *cash* në shumën 470.000 lekë deri në datën 26.01.2017.

Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, si më poshtë:

Apartament, me sipërfaqe 62 m² me adresë: Rr. “(*),” sh. (***), ap. (***),** blerë në vitin 2008, me kontratë shitje nr. (***), (kopje të saj bashkëlidhur këtij deklarami), regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në datën 22.5.2008, në regjistrin hipotekor me nr. (***), pasuria numër (***), në z. k. (***), (kopje të saj bashkëlidhur këtij deklarami).

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga dhe shpërblime në “U.” sh.p.k., si kancelare dhe pedagoge e brendshme dhe pjesa tjetër me anë të kredisë nga ‘Alpha Bank’ me kontratën e kredisë nr. (***), datë 2.6.2008, dhe shtojcave të saj (kopje të tyre bashkëlidhur këtij deklarami), me afat 10 vjet amortizuar gradualisht prej vitit 2008 deri në janar 2015, me këste të përmuajshme prej 158 euro/muaj dhe pjesa e mbetur e huas paguar plotësisht në janar 2015 në shumën prej 6.150 euro.

Burimi i tyre, depozita ekzistuese në “Alpha Bank” nga të ardhurat të mbledhura në vite nga paga dhe shpërblime nga puna në “U.” sh.p.k., dhe si mjete specializante në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (vërtetime për të ardhurat e mia në këto institucione bashkangjitur këtij deklarami).

Vlera 4.250.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011: “Apartament me sip. 62 m², blerë më 29.4.2008 me adresë: Rr. (***), Pall. (***), Shk (***), Ap. (***). Burimi i krijimit: 2.000.000 (dy milionë) lekë nga të ardhura si kancelare dhe pedagoge në U. . U.((***) 19.000 (nëntëmbëdhjetë mijë) euro kredi nga ALPHA BANK. (vlera) 4.250.000 (katërmilionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë; (pjesa që zotëron) 100 %”.

Me shkresën nr. (***), prot., datë 25.7.2019, “Alpha Bank” informon Komisionin se mund të vërë në dispozicion informacion që i përket periudhës prej datës 2.3.2009 e në vijim, për shkak të ndryshimit të sistemit informatik, që ka sjellë mosaksesimin e platformave të mëparshme.

Në të tilla rrethana Komisioni ka administruar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me:

- Kontratën për kufi kredie shumëqëllimore nr. (***), datë 2.6.2008, nr. (***), me palë kredihënëse “Alpha Bank” dhe kredimarrëse znj. E. B. të shumës prej 21.000 euro.
- Kontratën e hipotekës nr. (***), datë 2.6.2008, me anë të së cilës ka hipotekuar për “Alpha Bank”, pasurinë e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, nr. (***), vol. 20, f. (***), z. k. (***).
- Kontratën e shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. (***), datë 29.4.2008, me palë shitëse B. Ç., N. D. (bashkëshortët e B. Ç. dhe N. D.) A. Ç. (D.) dhe A. D. (B.), me palë blerëse E. B., të pasurisë apartament të ndodhur në Rr. “(***),” ap. (***), k. (***), Tiranë, me sip. 62 m², e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në regjistrin hipotekor nr. (***), datë 20.2.2008, në z. k. (***), pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), në vlerën 4.250.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës së noterit.

- Vërtetim nga dokumenti hipotekor, lëshuar në datën 20.2.2008, nëpërmjet të cilit vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. (***) datë 20.2.2008, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve B. Ç. dhe N. D., pasuria nr. (***) z. k. (***) me sip. 62 m²; harta treguese e pasurisë nr. (***) z. k. (***) me sip. 62 m²; planimetria dhe planvendosja e apartamentit; prokurë e posaçme, datë 27.2.2008, për të përfaqësuarit B. Ç., N. D., A. Ç. (D.) dhe A. D. (B.) nga shtetasi A. Gj. për shitjen e pasurive të paluajtshme në emër të tyre.

Transaksioni i mësipërm konfirmohet me shkresën nr. (***) prot., datë 16.9.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, sipas të cilës në emër të E. K. figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 62 m² me nr(***), z. k. (***)

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë pasurinë në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën ‘Vetting’.

Në lidhje me burimin e të ardhurave (2.000.000 lekë kredi nga “Alpha Bank”; si dhe 19.000 euro të ardhura të realizuara nga paga si kancelare dhe pedagoge në A. U.).

Kredia e deklaruar në deklaratën vetting konfirmohet nga përgjigja e bankës ALPHA Bank sh.a., kredi në shumën 2.000.000 lekë.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në dt. 12.1.2015 të mund të shlyente shumën prej **19.000 euro**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë.

Shpenzimet e shlyerjes së kredisë janë përfshirë në analizën financiare të subjektit nga viti 2011, vit në të cilin subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike bashkëshorten e tij në përbërjen familjare. Edhe në përgjigje të pyetësorit të dytë subjekti ka deklaruar se bashkëjetesa e tij me bashkëshorten ka filluar që në dhjetor të vitit 2010 dhe në analizën financiare janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga viti 2011 e në vijim.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e ka shlyer plotësisht detyrimin ndaj “Alpha Bank” lidhur me këtë kredi në vitin 2015. Si burim për shlyerjen përfundimtare të kësaj kredie bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e depozitës në “Alpha Bank” në vitin 2015.

Nga analiza financiare e pasqyruar në tabelën në vijim, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë patur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet e kryera për shlyerjen e kredisë së marrë në “Alpha Bank”, e cila rezulton e shlyer plotësisht në vitin 2015, me të ardhurat e ligjshme të gjeneruara.

Në vijim e pasqyruar analiza financiare për vitet në të cilat është paguar kredia:

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|------------------|-------------|----------------|----------------|----------------|
| PASURI | 3,766,157 | -448 | 433,727 | 484,715 | 113,226 |
| Apartament banimi shoqëria "****" shpk | | | 462,693 | | |
| Vend parkim, garazh në Rr. *** | | | 140,210 | | |
| Automjet tip Mercedes Benz me targa *** | | | | 700,550 | |

| | | | | | |
|--|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shtesa/pakësime likuiditete <i>cash</i> dhe bankë | 116,484 | -448 | -169,176 | -215,835 | 113,226 |
| DETYRIME | -353,570 | -216,857 | -204,856 | -230,250 | -217,704 |
| Kredi për blerje shtëpie në Raiffeisen Bank në vitin 2006 | -353,570 | -216,857 | -204,856 | -230,250 | -217,704 |
| PASURI NETO | 470,054 | 216,409 | 638,583 | 714,964 | 330,929 |
| TE ARDHURA dokumentuar | 2,426,536 | 2,218,706 | 1,976,962 | 2,405,852 | 3,182,037 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,280,113 | 1,278,932 | 1,185,700 | 1,454,984 | 1,515,599 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | 1,146,423 | 697,331 | 772,433 | 903,633 | 1,288,117 |
| Të ardhura nga interesat bankare | | 12,443 | 18,829 | 22,235 | 10,316 |
| Të ardhura nga dhurata nga babai i subjektit të rivlerësimit për vajzën e subjektit | | 230,000 | | | 230,355 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit BMW | | | | 25,000 | |
| Të ardhura nga shitja e automjetit Ford Fiesta | | | | | 137,650 |
| SHPENZIME | 995,906 | 1,138,061 | 1,036,505 | 1,591,150 | 2,197,996 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | | 115,901 | 109,305 | 102,509 | 95,506 |
| Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga bashkëshortja llogaritur nga viti 2011 e mbrapa | 262,415 | 261,349 | 275,089 | 269,866 | 833,570 |
| Shpenzime për regjistrimin/vlerësimin e pronës | | | | | |
| Shpenzime për lindjen e vajzës A. K., datë 23.10.2015 në spitalin *** | | | | | 130,000 |
| Shpenzime për çerdhjen e vajzës J. K | | 15,000 | | | |
| Shpenzime për doktoratën nga bashkëshortja e subjektit | 100,000 | 104,600 | | | |
| Shpenzime jetese | 409,860 | 423,072 | 423,072 | 659,994 | 897,104 |
| Shpenzime udhëtimi | 9,346 | 3,853 | 14,753 | 42,033 | 27,530 |
| Shpenzim arredimi | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 |
| Shpenzime doganore për makinën | | | | 302,463 | |
| Analiza dokumentuar | 960,576 | 864,236 | 301,874 | 99,736 | 653,111 |

Nga sa më sipër:

- Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën në kursime si dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë periudhës 2011 – 2015.

Depozitë bankare në “Alpha Bank” me afat një vjeçar me normë interesi 0.27 % (*bashkëlidhur vërtetimi bankar*).

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe shpërblime nga puna si kancelare për periudhën 2005 – 2011 në U. (A. U.), si pedagoge e brendshme në U. (A. U.), si mjeke specializante pranë shërbimit të autonomisë në QSTU për periudhën 2008 – 2012 (*vërtetimet për të ardhurat nga këto institucione bashkëlidhur këtij deklarami*).

Vlera 13.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja e shkresës më nr. (***) prot., datë 25.7.2019, të “Alpha Bank” .

Kjo llogari depozite është krijuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit para martesës në vitin 2005 dhe është deklaruar për herë të parë nga personi i lidhur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011. Kjo llogari depozite ka pasur shtesa dhe pakësime nga viti 2011 dhe deri në deklaratën “Vetting”. Depozita, gjendja e të cilës në vitin 2014 ka qenë në shumën 20.000 euro, është përdorur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për të mbyllur kredinë e marrë në “Alpha Bank” për blerje shtëpie, siç dhe është deklaruar në deklaratën e interesave private periodike vjetor të vitit 2015.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 25.1.2017 të mund të krijonte gjendje në depozitë në shumën **13.000 euro**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë.

Analiza financiare e të ardhurave të ligjshme të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, gjendet në vijim të materialit

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në “Alpha Bank” në emër të saj, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës.
- Rezulton se subjekti ka pasur mundësi që të krijonte gjendjen në shumën 13.000 euro deri në datën 25.1.2017

Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank” në lekë.

Burimi i krijimit: paga si pedagoge e jashtme nga viti 2014 e në vijim, si dhe konsulente për zhvillimin kurrikular të Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë A. U. (ish U.) nga tetor 2014 e në vijim (*bashkëlidhur vërtetim bankar, datë 20.1.2017*).

Vlera 980 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja me shkresën nr(***)prot., datë 25.7.2019 të “Alpha Bank”.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Alpha Bank” në emër të saj, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj gjendjeje.
- Rezulton se subjekti ka pasur mundësi që të krijonte gjendjen në shumën 980 lekë deri në datën 20.1.2017.

Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank” në euro.

Burimi i krijimit: të ardhura nga norma e interesit të depozitës ekzistuese në “Alpha Bank” (si më sipër shpjeguar, bashkëlidhur vërtetimit bankar),.

Vlera: 29.97 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja me shkresën nr. (***) prot., datë 25.7.2019, të “Alpha Bank”.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Alpha Bank” në emër të saj, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj gjendjeje.

Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” . Burimi i krijimit: paga si mjeke pranë Shërbimit të Anatomisë Patologjike në QSUT (*bashkëlidhur vërtetimi përkatës, datë 16.1.2017*).

Vlera 1.164 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja me shkresë nr. (***) prot., datë 3.9.2019, të “Credins Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 16.1.2017 të mund të krijonte gjendje në llogari rrjedhëse në shumën **1.164 lekë**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

Sipas informacionit të administruar gjatë hetimit administrativ nga “Credins Bank” rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur disa llogari pranë “Credins Bank”, njëra prej të cilave është llogaria rrjedhëse e lartpërmendur. Informacioni i parë lidhur me këtë llogari na vjen nga viti 2008. Në këtë llogari bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit i ka kaluar paga që nga viti 2008 nga punësimi i saj pranë QSUT “Nënë Tereza”. Kjo llogari është aktive nga viti 2008 e në vijim.

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank” në emër të saj, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj gjendjeje.

Depozitë në “Credins Bank”.

Burimi i krijimit: mbetje nga tërheqja e shumës prej 1.293.300 lekësh, në korrik të vitit 2012, të mbledhura nga paga si mjeke specializante pranë QSUT-së.

Vlera 583.5 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

Shuma e deklaruar në deklaratën “Vetting” konfirmohet nga përgjigja me shkresën nr. (***) prot., datë 3.9.2019, të “Credins Bank”.

Komisioni hetoi dhe kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë paguese të personit të lidhur, që me burimet e ligjshme të deklaruara deri në datën 11.10.2016 të mund të krijonte gjendje në depozitë në shumën **583.5 lekë**, së bashku me deklarimin e pagesave të tjera të deklaruara deri në këtë datë, sikurse në tabelën e mëposhtme:

Nga sa më sipër:

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë rrjedhëse “Credins Bank” në emër, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj gjendjeje.

Llogari rrjedhëse në “ProCredit Bank”.

Burimi i krijimit: llogari ku është derdhur më parë paga nga U., kaluar më pas në llogarinë rrjedhëse në “Alpha Bank” **0 (zero) lekë**. Pjesa takuese: 100 %.

- Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë rrjedhëse në emër të saj në “ProCredit Bank”.

Analiza financiare e të ardhurave të ligjshme të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ Komisioni realizoi një analizë financiare për personin i lidhur, bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, znj. E. K. (B.) deri në vitin 2011, si dhe iu kërkua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit¹² që të na vinte në dispozicion kontratat e punës dhe listpagesat e bashkëshortes për periudhën 2011 – 2016.

Evidentojmë se analiza financiare deri në vitin 2011 përfshin evidentimin e burimeve të ligjshme të saj dhe gjendjen e likuiditeteve në bankë, duke marrë në konsideratë faktin se personi i lidhur nuk ka qenë subjekt deklarimi.

Në këtë analizë janë marrë në konsideratë:

- Për të ardhurat nga paga i jemi referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit nga ana e Komisionit, vërtetimeve nga institucionet ku bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar si dhe dokumentacionit që subjekti na vuri në dispozicion gjatë hetimit administrativ.
- Lidhur me shpenzimet e jetesës i jemi referuar shpenzimeve të jetesës që na ka vënë në dispozicion ILDKPKI vetëm për një person.
- Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve i jemi referuar udhëtimeve të identifikuara nga sistemi *TIMS* dhe të përlllogaritura sipas metodologjisë së vendimit të KPA-së për E. I.;
- Në analizën e vitit 2008 nuk kemi informacion nga “Alpha Bank” lidhur me shlyerjen e kredisë për këtë vit por në deklarimin për herë të parë të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera ajo ka deklaruar “...Kredi në Alpha Bank për blerje apartamenti, marrë në datën 2.6.2008, shuma 19.000 (nëntëmbëdhjetë mijë) euro, afati 10 vjet, me këst mujor 157,7 euro.” Shuma e detyrimit të shlyer nga bashkëshortja e

¹² Shiko pyetësorin Nr.5 të dërguar subjektit të rivlerësimit nga Komisioni me datë 24.10.2019

subjektit të rivlerësimit në këtë deklaram është **9171.83** euro, ndërsa gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer për këtë kredi është **9.828,17** (nëntë mijë e tetëqind e njëzet e tetë presje shtatëmbëdhjetë) euro.

Nisur nga ky deklaram duket se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar vetëm gjendjen e principalit të shlyer dhe bazuar tek deklarimet si dhe tek informacioni i administruar gjatë hetimit nga “Alpha Bank” kemi përlogaritur përafërsisht shpenzimet e shlyerjes së kredisë nga qershori i vitit 2008 e në vijim.

- Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të dhënat e sjella nga subjekti lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së tij, nga paga për të cilat janë paguar tatimet, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.
- Në analizën financiare të personit të lidhur konstatojmë se një pjesë e madhe e likuiditeteve të saj janë likuiditete në llogari bankare.
- Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2011, shpenzimet deri në fund të vitit 2011, pasuritë e blera prej saj deri në fund të vitit 2011, gjendja e detyrimit të mbetur të kredisë në “Alpha Bank” deri në fund të vitit 2011.

| Vitet | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | Total |
|---|---------------|----------------|----------------|-----------------------|------------------|-------------------------|------------------|------------------|-------------------------|
| Të ardhurat | 25,640 | 153,840 | 478,954 | 1,384,110 | 2,114,475 | 2,615,889 | 1,746,947 | 1,146,423 | 9,666,278 |
| Nga pagat sipas vërtetimeve të punësimit | 25,640 | 153,840 | 478,954 | 1,384,110 | 2,114,475 | 2,615,889 | 1,746,947 | 1,146,423 | 9,666,278 |
| Shpenzimet | 93,864 | 146,319 | 212,230 | 123,089 | 1,376,452 | 443,724 | 484,706 | 399,035 | 3,279,418 |
| Shpenzime jetese | 93,864 | 109,557 | 109,557 | 123,089 ¹³ | 136,620 | 136,620 | 136,620 | 136,620 | 982,547 |
| Shpenzime për shlyerje Kredie | | | | | 1,239,832 | 261,838 ¹⁴ | 263,411 | 262,415 | 2,027,496 |
| Shpenzimet për udhëtime | | 36,762 | 102,673 | 0 | 0 | 45,266 | 84,674 | 0 | 269,375 |
| Pasuri | | | | | | | | | 8,124,958 |
| Shtëpi banimi në Rr.***, Tiranë | | | | | 4,250,000 | | | | 4,250,000 |
| Automjet tip Ford Fiesta | | | | | 0 | | 200,000 | | 200,000 |
| Shtesa/pakësime në Likuiditete | | | 831,256 | 531,695 | -931,434 | 2,185,745 ¹⁵ | 1,032,411 | 25,285 | 3,674,958 ¹⁶ |
| Detyrime | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,340,468 | 0 | 0 | 0 | 1,359,212 |
| Kredi në Alpha Bank për blerje apartamentit | | | | | 2,340,468 | | | | 1,359,212 ¹⁷ |

¹³ Shpenzimet e jetesës së bashkëshortes së subjektit për vitin 2007 janë llogaritur si mesatare e ponderuar e viteve 2006 dhe 2008

¹⁴ Përlogaritja e shpenzimeve të shlyerjes së kredisë nga Alpha Bank nga muaji mars 2009, ndërsa për muajt janar dhe shkurt 2009 kemi marrë si referencë muajin mars 2009 dhe shpenzimet e shlyerjes së kredisë për këto dy muaj janë marrë të njëjta me muajin mars 2009

¹⁵ Informacioni nga “Alpha Bank” nga ku rezulton se për herë të parë depozita e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është çelur në vitin 2009

¹⁶ Totali i gjendjes së likuiditeteve në bankë në fund të vitit 2011

¹⁷ Detyrimi i mbetur i kredisë në fund të vitit 2011, marrë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit që në vitin 2008

| LIKUIDITETE DOKUMENTUAR | | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|------|------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| 1 | | 0 | 1,593,020 | 2,439,395 | 2,934,781 | 2,032,890 | 2,617,263 | 3,649,673 | 3,674,958 | 3,309,613 | 2,920,741 | 2,879,975 | 2,825,164 | 2,952,405 | |
| Alpha Bank E.K llogaria rrjedhëse | lekë | | | | | | | 33,223 | 109,831 | 26,382 | 1,154 | 555 | 0 | 245 | 153 |
| Alpha Bank E.K llogaria rrjedhëse | Eur | | | | | | | 138 | 47 | 631 | 6 | 18,104 | 5,204 | 293 | 4,055 |
| Alpha Bank E.K llogaria depozite | Eur | | 1,593,020 | 1,608,139 | 1,571,830 | 1,601,373 | 1,383,690 | 2,092,176 | 2,002,971 | 1,979,092 | 2,804,200 | 2,802,200 | 1,906,453 | 1,758,510 | |
| ProCredit Bank E.K llogari kursimesh | Eur | | | | | | | | | | | | 70,055 | 867,199 | 1,183,943 |
| ProCredit Bank E.K llogari rrjedhëse | lekë | | | 25,401 | 140,753 | 314,232 | 720,685 | 573,939 | 401,021 | 209 | 55,655 | 1,559 | 1,495 | 1,000 | |
| ProCredit Bank E.K llogari rrjedhëse | lekë | | | | | | | | | | | | | 0 | |
| Intesa SanPaolo Bank llogari rrjedhëse | lekë | | | 473,341 | 541 | | | | | | | | | | |
| Intesa SanPaolo Bank llogari rrjedhëse | Eur | | | 332,514 | 1,221,657 | | | | | | | | | | |
| llogari rrjedhëse në Credins Bank nga bashkëshortja e subjektit | lekë | | | | | 117,285 | 9,014 | 9,086 | 10,747 | 35,499 | 41,647 | 376 | 48,896 | 4,161 | |
| llogari depozite në Credins Bank | lekë | | | | | | 70,512 | 444,240 | 115,160 | 216 | 580 | 582 | 583 | 583 | |
| llogari depozite në Credins Bank | lekë | | | | | | 400,000 | 420,355 | 437,740 | 59 | | | | | |
| llogari depozite në Credins Bank | lekë | | | | | | | | 680,306 | | | | | | |
| llogari depozite në Credins Bank | lekë | | | | | | | | | 1,293,378 | | | | | |
| TOTAL LIKUIDITETE | | 0 | 1,593,020 | 2,439,395 | 2,934,781 | 2,032,890 | 2,617,263 | 3,649,673 | 3,674,958 | 3,309,613 | 2,920,741 | 2,879,975 | 2,825,164 | 2,952,405 | |

Komisioni, në analizë të provave të administruara, çmon se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë për pasuritë dhe likuiditetet e personit të lidhur. si dhe burimin e krijimit të saj.
- Personi i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

Analiza financiare e të ardhurave të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit

Komisioni çmoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit janë marrë në cilësinë e personit tjetër të lidhur, për sa më poshtë:

1. Prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultojnë në certifikatën familjare të tij deri në datën 21.5.2005;
2. Ekzistenca e llogarive bankare në emër të babait dhe të nënës së subjektit të rivlerësimit në vitet kur subjekti ka qenë në certifikatën familjare me prindërit;
3. Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 dhe 2014 subjekti ka deklaruar dhurata në vlera të ndryshme, përkatësisht në vlerën 100.000 lekë dhe 230.000 lekë për fëmijët e tij bërë nga prindërit.

Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit rezulton:

1. Referuar dokumenteve justifikues të depozituara nga subjekti, rezulton se babai i tij, z. Q. K., ka depozituar shuma në dollarë pranë Bankës së Kursimeve që në vitin 2000.
2. Babai i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në datën 1.2.2005 shumën prej 8.400 USD në “Raiffeisen Bank”, duke krijuar depozitë me afat. Në vijim, në datën 19.8.2005 ka depozituar në këtë llogari shumën prej 800 USD, duke arritur kjo llogari depozite prej 9.200 USD po në “Raiffeisen Bank” deri në vitin 2009. Më pas, në vitin 2009, kjo llogari është mbyllur dhe të dy prindërit e subjektit kanë çelur një llogari depozite dyemërore në vitin 2010 pranë “Credins Bank”, në shumën 1.040.000 lekë, e cila ka qenë aktive deri në vitin 2012, kur kjo depozitë është tërhequr.
3. Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. N. K., ka depozituar në datën 7.7.2004 shumën prej 1.500 euro, *cash*, në Bankën e Kursimeve, në një depozitë pa afat.
4. Në datën 13.8.2004, nëna e subjektit të rivlerësimit depoziton në Bankën e Kursimeve, në të njëjtën llogari, shumën prej 10.500 euro me përshkrimin “...*derdh në depozitë pa afat N. K. ...*”, *derdhje cash*.

5. Nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 14.11.2005 është depozituar shuma prej 15.000 euro e cila ka ardhur nëpërmjet një transferte të brendshme, e cila deri në vitin 2016, ka qenë në shumën 20.000 euro.

Në pyetësonin nr. 5 subjektit të rivlerësimit iu kërkua të deklaronte burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij lidhur me këto depozita.

Në përgjigje të këtij pyetësoni subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se : *“Llogaria bankare depozitë e hapur në valutë Euro në emër të nënës time N. K. në “Raiffeisen” Bank përfaqëson kursimet e përbashkëta të prindërve të mi gjatë jetës së tyre. Në këtë llogari depozite, unë si subjekt i rivlerësimit së bashku me familjen time, nuk kam kontribuar në krijimin ose shtimin e saj në asnjë rast, si dhe nuk kam qenë pjesë e përfitimeve të saj”*.

Të njëjtin sqarim subjekti i rivlerësimit ka dhënë dhe për depozitën e çelur nga babai i tij në monedhën dollarë në vitin 2005.

Subjekti shoqëroi deklarinin në pyetëson me dokumente ligjorë justifikues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit sipas dokumentacionit ligjor justifikues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit të konsideruara si të ardhura të ligjshme në kuptim të ligjit:

| Të ardhura sipas viteve | 1996-1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | Total 1996-2005 |
|---|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------------|
| Babai i subjektit Q. K, elektrikist | 212,890 | 113,236 | 123,486 | 153,922 | 148,956 | 195,448 | 152,560 | 189,446 | 267,613 | 1,557,557 |
| Nëna e subjektit N.K, ASHR | 143,233 | 93,228 | 102,438 | 117,699 | 34,748 | 108,433 | 163,877 | 169,604 | 185,657 | 1,118,917 |
| Total të ardhura prindërit e subjektit të rivlerësimit | 356,123 | 206,464 | 225,924 | 271,621 | 183,704 | 303,881 | 316,437 | 359,050 | 453,270 | 2,676,474 |

| Të ardhura sipas viteve | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | Total 2006-2015 |
|--|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------------|
| Babai i subjektit Q. K | 285,802 | 333,553 | 331,015 | 365,481 | 513,063 | 463,587 | | | | | 4,018,379 |
| Nëna e subjektit N. K | | 260,974 | 257,858 | 296,244 | 311,748 | 324,638 | 335,227 | 341,021 | 379,993 | 155,993 | 3,880,957 |
| Total prindërit e subjektit të rivlerësimit | 285,802 | 594,527 | 588,873 | 661,725 | 824,811 | 788,225 | 335,227 | 341,021 | 379,993 | 155,993 | 4,956,197 |

Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit së bashku me prindërit deri në vitin 2004

Komisioni çmoi se duke qenë se në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përbërjen e tij familjare së bashku me prindërit e tij, realizoi analizën financiare për subjektin dhe për prindërit e tij. Kjo analizë i referohet dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, deklarimeve dhe sqarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësonit nr. 5, shoqëruar me dokumentet përkatës lidhur me të ardhurat e prindërve të tij.

| | Para 2003 | 2003 | 2004 |
|---|------------------|----------------|------------------|
| TË ARDHURA dokumentuar | 3,098,914 | 914,253 | 1,149,369 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 1,551,197 | 597,816 | 790,319 |

| | | | |
|---|-------------------------|----------------|----------------|
| Të ardhura nga paga babai i subjektit të rivlerësimit | 947,938 | 152,560 | 189,446 |
| Të ardhura nga paga nëna e subjektit të rivlerësimit | 599,779 | 163,877 | 169,604 |
| SHPENZIME | 2,099,354 | 451,456 | 435,456 |
| Shpenzime jetese | 2,004,354 ¹⁸ | 375,456 | 375,456 |
| Shpenzime qiraje gjatë qëndrimit në Sarandë ¹⁹ | 95,000 | 76,000 | 60,000 |
| Analiza dokumentuar | 999,560 | 462,797 | 713,913 |

Në përfundim të kësaj analize financiare, duke marrë në konsideratë faktin se personat e tjerë të lidhur nuk kanë qenë subjekte deklarimi, për të arritur në një analizë të saktë të likuiditeteve të krijuara, Komisioni çmon se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur burime të ligjshme për të bërë të mundur krijimin e mundësisë për të dhuruar shumën prej 100.000 dhe 230.000 lekë për fëmijët e subjektit.

Konkluzionet përfundimtare për kriterin e pasurisë

Komisioni në përfundim të këtij hetimi administrativ çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare për subjektin e rivlerësimit duhet të marrë në konsideratë, si më poshtë vijon;

Siç konstatohet dhe më lart nga subjekti i rivlerësimit Komisioni ka konstatuar:

- Subjekti në analizën financiare të realizuar nga Komisioni rezulton me një diferencë në vlerë 856.228 lekë (referuar dy momenteve të blerjes së dy pasurive ku subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme).
- Subjekti ka nënshkruar në deklaratë noteriale fiktive me babanë e tij, e gjendur në dokumentacionin e marrjes së kredisë së butë;

Për sa më sipër janë konstatimet të cilat Komisioni çmon ti vlerësojë në vendimmarrjen e tij në respektim të ligjit, të qëllimit të ligjit dhe respektimit të parimit të proporcionalitetit, si një nga parimet më të rëndësishme në dhënien e një mase disiplinore.

Lidhur me faktin se a kemi pasaktësi nga subjekti në deklaratimet periodike duke mosdeklaruar kontratën e sipërmarrjes dhe cila është pasoja që ka ardhur në drejtim të realizimit të procesi të rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se për padyshim qëndron detyrimi që të deklarojë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9049/2003 dhe për këtë çështje Kolegji ka mbajtur qëndrimin e tij.

¹⁸ Shpenzimet e jetesës para vitit 2003 janë llogaritur nga viti 1996. Për periudhën 1996–1997 shpenzimet e jetesës për prindërit e subjektit janë llogaritur si 80% e të ardhurave, për periudhën 1998-1999 shpenzimet e jetesës janë llogaritur me 5.000 lekë/muaj ndërsa për periudhën 2000–2002 janë llogaritur bazuar në shkresën e ILDKPKI-së lidhur. Në shpenzimet e jetesës është përfshirë dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit sipas ILDKPKI-së si anëtar i familjes së subjektit.

¹⁹ Subjekti i rivlerësimit ka qenë i punësuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë për periudhën tetor 2001– nëntor 2005 dhe nëpërmjet pyetësorit nr. 7 atij iu kërkuan sqarime lidhur me adresën e banimit gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar në Gjykatën e Sarandës dhe në përgjigje të pyetësorit ndër të tjera na sqaroi se: *...Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës sime si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë Sarandë, fillimisht unë kam banuar në apartamentin në pronësi të tezes time (motrës së mamasë time) S. J. dhe bashkëshortit të saj L. J. . Në apartamentin e tezes time, kam banuar në dy periudha të ndryshme kohore që janë: tetor 2001 - mars 2002; shtator 2003 - nëntor 2005.....Gjatë kohës së qëndrimit tim në banesën e tezes time, unë i kam dhënë tezes time shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj si një formë shpërblimi për strehimin, ushqimin dhe shërbimeve të tjera që unë kam marrë prej saj gjatë asaj kohe.... Rreth muajit mars të vitit 2002 deri në shtator të vitit 2003 unë kam jetuar me qera në apartamentin 1 + 1 të shtetasit D. S. nga i cili vetëm njëra dhomë dhe ambientet e tjera funksionale më ishin vënë në dispozicion....Gjatë kohës së qëndrimit tim në apartamentin e marrë me qira, unë i kam paguar shtetasit D. S. shumën prej 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj.*

Kolegji lidhur me këtë në vendimin nr. 20/2019, në pikat 55 dhe 56 të tij, përcaktohet se: [...] *Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar. ... Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurore e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues [...].*

Për sa më sipër, duke qenë se subjekti në fund të vitit kalendarik ishte në situatën e një kredie të *disbursuar* dhe në kushtet e pamundësisë së ekzekutimit të një kontrate për shkak të ndryshimit të destinacionit të objektit, Komisioni çmon se subjekti nuk kishte detyrimin për ta deklaruar këtë kontratë.

Komisioni vlen të nënvizojë se edhe sikur për subjektin e rivlerësimit kjo të konsiderohet si një pasaktësi e konstatuar në deklaratën periodike vjetore, duhet të analizohet se cila është pasoja që sjell kjo parregullsi në raport me procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë.

Në këtë analizë Komisioni çmon se referuar vendimmarrjes së deritanishme të tij apo dhe të qëndrimeve të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji²⁰, pasaktësitë në deklarime nuk mund të konsiderohen si shkelje të asaj mase, të cilat mund të shërbejnë si bazë ligjore për marrjen e masës së shkarkimit.

Në vendimin nr. 5/2019 përcaktohet se [...]: “...Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit Faqja 13 nga 37 vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklarimit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklarim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit...”

Në vendimin nr. 19/2019, në pikat 22.14 dhe 22.15 të tij përcaktohet se [...] ... *Trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklarim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e Faqe 11 nga 18 subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më*

²⁰ 85 Vendimet e Kolegjit nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.0.2019.

parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaratës “Vetting” dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërvëprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të [...].

Në bazë të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për efekt të këtij procesi, vlerësojmë se pasaktësia nuk është bërë me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë.

Në rastin konkret nga hetimi nuk rezultoi nga analiza e provave të administruara gjatë hetimit se mosdeklarimi i kontratës së sipërmarrjes së subjektit me shoqërinë “F.” sh.p.k., të kishte si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo të vinte në dyshim ligjshmërinë e krijimit të burimit të ligjshëm të saj.

Për këtë arsye Komisioni çmon se nuk jemi në kushtet e zbatimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, në analizë të gjetjeve, trupi gjykues çmon se nuk jemi as para zbatimit të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pra, të cenimit të besimit të publikut nga subjekti irivlerësimit.

Cenimi i besimit të publikut nga ana e magjistratit është i lidhur ngushtë me faktin se ky i fundit duhet të bëjë një shkelje ligjore gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij. Në rastin konkret është shumë e rëndësishme të arsyetojmë se cila do të ishte masa kësaj shkeljeje dhe sa një shkelje e caktuar mund të cenoj besimin e publikut, për të legjitimuar marrjen e një vendimi në respektim të parimit të proporcionalitetit.

Komisioni çmon se marrja e një mase disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit është në përputhje me qëllimin e ligjit për rivlerësimin. Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me faktin se si duhet të jetë sjellja e një gjyqtari gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Në vendimin nr. 28/2019, në pikën 41, dhe 22.15 të tij përcaktohet se [...] *Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimin e detyrës parësore të një gjyqtari, nëpërmjet*

vendimeve të dhëna, por jo vetëm. Sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i pushtetit gjyqësor, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembujt më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Më konkretisht, Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: “Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore”. 43. Në komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve, në komentari shtjellohet, ndër të tjera: Paragrafi 108 – Kërkohet respektimi i rreptë i ligjit – Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit [...]. Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, të gjyqtari mund të tërheqë publicitet dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.

Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një “gjyqtar i mirë”, por edhe një “person i mirë”, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën[...]

[...] Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji. Ky përfundim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitet lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50] në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për

shkak të kontratave fiktive për të përfituar kredi bankare, dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim [...].

Në rastin konkret përdorimi nga subjekti i rivlerësimit të një deklarate noteriale fiktive me babanë e tij, si dhe ekzistenca e nja balance të vogël në analizën financiare të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit përbëjnë arsye të cilat nuk mund të konsiderohen si mënyrë sjellje e subjektit në kundërshtim me ligjin, që ka pasur si qëllim përfitimin e një të drejtë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi. Subjekti në rastin konkret i përmbushte në mënyrë të qartë kriteret për përfitim të kredisë, nuk dispononte asnjë pasuri tjetër dhe për pasojë shkalla e shkeljes nga subjekti nuk mund të konsiderohet si një shkelje etike e rëndë, e vetmja në vlerësimin profesional të tij gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si gjyqtar, e cila të shërbejë si shkak i mjaftueshëm për marrjen e një mase disiplinore për shkarkimin nga detyra.

E njëjta logjikë, e bazuar në parimin e proporcionalitetit, vlen dhe duhet të përdoret në analizimin në harmoni të të gjitha kriterëve të këtij procesi rivlerësimi, përfshirë këtu edhe kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se diferencat e konstatuara në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk mund të çojnë në një përfundim të përgjithshëm mbi mungesën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk mund të passjellin shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij.**
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarinin më sipër si dhe masa e konstatuar në mungesën e burimeve të ligjshme, nuk është në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkim sipas pikës 3, të nenit 61, dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.**
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit KLODIAN KURUSHI – Gjyqtar – Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

| | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|----------------|------------------|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| PASURI | 0 | 184,480 | 250,031 | 5,231,420 | 148,124 | 253,895 | 154,732 | 4,451,091 | 116,484 | -448 | 433,727 | 484,715 | 113,226 | 175,374 |
| Apartament banimi 2+1 me sip.100 m ² , Rr.*** | | | | | | | | | | | | | | |
| Autoveturë tip BMW 3C, vit prodhimi 1992 me targë *** | | | 250,000 | | | | | | | | | | | |
| Apartament banimi shoqëria ***** shpk, paguar kësti I parë në 2007 | | | | | 5,028,000 | 500,000 | | | | | 462,693 | | | |
| Vend parkim, garazh në rr.*** | | | | | | | | 832,860 | | | 140,210 | | | |
| Automjet tip Mercedes Benz me targa *** | | | | | | | | | | | | 700,550 | | |
| Apartament me sip.62 m ² I bashkëshortes së subjektit blerë në 2008 | | | | | | | | | | | | | | |
| Automjet Ford Fiesta i bashkëshortes së subjektit blerë në 24.05.2010 | | | | | | | | | | | | | | |
| Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë | 0 | 184,480 | 31 | 5,231,420 | -4,879,876 | -246,105 | 154,732 | 3,618,231 | 116,484 | -448 | -169,176 | -215,835 | 113,226 | 175,374 |
| Total likuiditete | 1,336,500 | 1,520,980 | 31 | 5,231,452 | 351,575 | 105,470 | 260,202 | 3,878,433 | 3,994,917 | 3,994,469 | 3,825,293 | 3,609,458 | 3,722,684 | 3,898,058 |
| DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 4,916,810 | -332,759 | -332,759 | -332,759 | -332,759 | -353,570 | -216,857 | -204,856 | -230,250 | -217,704 | -244,469 |
| Kredi për blerje shtëpie në Raiffeisen Bank në vitin 2006 | | | | 4,916,810 | -332,759 | -332,759 | -332,759 | -332,759 | -353,570 | -216,857 | -204,856 | -230,250 | -217,704 | -244,469 |
| PASURI NETO | 0 | 184,480 | 250,031 | 314,610 | 480,882 | 586,653 | 487,491 | 4,783,850 | 470,054 | 216,409 | 638,583 | 714,964 | 330,929 | 419,843 |
| TË ARDHURA dokumentuar | 914,253 | 1,149,369 | 839,111 | 1,100,236 | 1,136,542 | 1,128,623 | 1,078,049 | 4,804,174 | 2,426,536 | 2,218,706 | 1,976,962 | 2,405,852 | 3,182,037 | 2,900,370 |
| Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit | 597,816 | 790,319 | 839,111 | 1,100,236 | 1,136,542 | 1,128,623 | 1,078,049 | 1,154,501 | 1,280,113 | 1,278,932 | 1,185,700 | 1,454,984 | 1,515,599 | 1,477,684 |
| Të ardhura nga paga babai i subjektit të rivlerësimit | 152,560 | 189,446 | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga paga nëna e subjektit të rivlerësimit | 163,877 | 169,604 | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit | | | | | | | | | 1,146,423 | 697,331 | 772,433 | 903,633 | 1,288,117 | 1,174,980 |
| Dhurata të mbledhura nga familjarë dhe të afërm për lindjen e vajzës A.K | | | | | | | | | | | | | 230,355 | |
| Të ardhura nga interesat bankare | | | | | | | | | | 12,443 | 18,829 | 22,235 | 10,316 | 7,706 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të bashkëshortes Ford Fiesta | | | | | | | | | | | | | 137,650 | |
| Likuiditete të mbartura nga bashkëshortja e subjektit para martesës | | | | | | | | 3,649,673 | | | | | | |
| Të ardhura nga dëmshpërbilimi si pasojë e akidentit | | | | | | | | | | | | | | 120,000 |
| Të ardhura nga dhurata nga babai i subjektit të rivlerësimit për vajzën e subjektit | | | | | | | | | | 230,000 | | | | |
| Të ardhura nga dhuratat për ditëlindjen e vajzës A.K | | | | | | | | | | | | | | 120,000 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit të subjektit BMW | | | | | | | | | | | | 25,000 | | |
| SHPENZIME | 451,456 | 435,456 | 174,467 | 229,093 | 153,316 | 270,956 | 409,889 | 483,042 | 995,906 | 1,138,061 | 1,036,505 | 1,591,150 | 2,197,995 | 1,067,685 |
| Shpenzime interesa/komisione/sig.prone për kredinë e marrë nga subjekti në vitin 2006 | | | | 76,240 | | 60,426 | | | | 115,901 | 109,305 | 102,509 | 95,506 | 100,017 |
| Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë nga bashkëshortja llogaritur nga viti 2011 | | | | | | | | | 262,415 | 261,349 | 275,089 | 269,866 | 833,570 | |
| Shpenzime qiraje gjatë qëndrimit në Sarandë | 76,000 | 60,000 | 50,000 | | | | | | | | | | | |
| Shpenzime për regjistrimin/vlerësimin e pronës | | | | | | | | | | | | | | 27,300 |
| Shpenzime për lindjen e vajzës A.K dt.23.10.2015 në spitalin *** | | | | | | | | | | | | | 130,000 | |
| Shpenzime për çerdhen e vajzës J.K | | | | | | | | | | 15,000 | | | | |
| Shpenzime për doktoraturën nga bashkëshortja e subjektit | | | | | | | | | 100,000 | 104,600 | | | | |
| Shpenzime doganore për makinën e blerë në vitin 2014 | | | | | | | | | | | | 302,463 | | |
| Shpenzime jetese | 375,456 | 375,456 | 109,557 | 109,557 | 123,089 | 136,620 | 136,620 | 136,620 | 409,860 | 423,072 | 423,072 | 659,994 | 897,104 | 940,368 |
| Shpenzime udhëtimi | | | 14,910 | 43,296 | 30,228 | 73,910 | 58,983 | 132,136 | 9,346 | 3,853 | 14,753 | 42,033 | 27,530 | 0 |
| Humbje nga shitja e makinës BMW | | | | | | | | | | | | | | |
| Shpenzim arredimi | | | | | | | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 | 214,286 | |
| Analiza dokumentuar | 462,797 | 529,433 | 414,613 | 556,533 | 502,344 | 271,014 | 180,669 | -462,717 | 960,576 | 864,236 | 301,874 | 99,738 | 653,113 | 1,412,841 |

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Klodian Kurushi, ku ka konstatuar se:

- i. formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës;
- iii. për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar;

në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Klodian Kurushi. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. (***) prot., datë 24.1.2019, të KDZh-së.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykuesi vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, ka përgatitur raportin për analizën e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Klodian Kurushi, duke u mbështetur në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë

paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Në analizë të Raportit të Vlerësimit të kryer nga KLD duket se, Ju keni treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, keni respektuar të drejtat e palëve, jeni eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

2. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i. raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga Inspektorati i KLD-së dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij;
- ii. vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese;
- iii. kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavaruar 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga ana juaj, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Pas verifikimit të raportit Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

Komisioni, në tërësi, vërejti se subjekti i rivlerësimit ndalet për të identifikuar kërkimet e organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes, i analizon ato në raport me provat e paraqitura dhe konkludon për faktin penal, si dhe masën e dënimit që duhet caktuar. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, duke i bërë ato pjesë të vendimeve gjyqësore. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore bëhet rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërmjetme, konstatohet referenca tek vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë sikurse është rasti i vendimit unifikues nr. 03/2011, lidhur me ardhjen e pasojës, e cila është e ndërprerë për shkaqe të paparashikuara nga vullneti i të pandehurit, apo vendimi tjetër unifikues nr. 02/2003 i Gjykatës së Lartë për gjykimin e shkurtuar (shih dosjet nr. 1, 2 dhe 4). Komisioni konstaton se, në tre dokumentat ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se gjyqtari Klodian Kurushi identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve.

Gjyqtari Klodian Kurushi, ka njohuri shumë të mira të së drejtës penale për ato vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale nuk është përfunduar, është ndërprerë për shkaqe të pavaruara nga vullneti i tij dhe masa e dënimit nga Gjykata e Krimeve të Rënda është caktuar në kufijtë minimal që parashikon dispozita penale konkrete (shih dosjet nr. 1 dhe 2), si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit (shih dokumentet nr. 1 dhe 2). Gjithashtu, ai njeh dhe zbaton drejt procedurën e gjykimit të shkurtuar (shih dokumentet nr. 1 dhe dosjet nr. 1, 2, 3 dhe 4).

Konstatohet se subjekti respekton etikën në punë dhe integritetin profesional, si dhe ka treguar gatishmëri për t'u angazhuar në aktivitete profesionale. Gjithashtu, ka pjesëmarrje si ekspert e lehtësues në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në periudhën maj 2014 – aktualisht.

b. Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë depozituar 6 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Klodian Kurushi.

Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

- ✓ Nga shqyrtimi në tërësi i këtyre denoncimeve duket se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe me figurën e subjektit të rivlerësimit.

RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Për sa më sipër, pasi u hetua, analizua dhe u vlerësua raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni arrin në konkluzionin se nuk ka indice apo elemente nga të cilat të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale në përfundim Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, “të aftë” në detyrën e gjyqtarit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Klodian Kurushi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 10.12.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta